



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 431/3 Prot

Tiranë, më 06/7 / 2015

REKOMANDIM

Nr. 32 datë 06/7 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar në ngarkim të kontrolluesit **Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës**,

KONSTATOVA:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është paraqitur ankesa e shtetasit me initiale (B.D). Ky shtetas i është drejtuar zyrës së Komisionerit me ankesë ku pretendon se, Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës ka publikuar listën me emrat e studentëve debitor, duke e afishuar në stendën e katit të parë brenda ambjentit të Fakultetit.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe zgjidhjes së ankesës, zyra e Komisionerit i është drejtuar kontrolluesit, Fakultetit të Ekonomisë me shkresën Nr. 431/1 Prot, datë 27.05.2015, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion lidhur me bazën ligjore të kontrolluesit për publikimin e listave me emrat e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen, të cilët janë debitor.

Në përgjigjen e kthyer me shkresën Nr. 739/1 Prot, datë 08.06.2015, Fakulteti i Ekonomisë ka paraqitur sqarime, ku është shprehur se, publikimi i listave me emrat e studentëve, bazohet në:

- Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH" (i ndryshuar);
- VKM nr. 517, datë 01.08.2014 pika 8;
- VKM nr 668, datë 15.10.2014, pika 18.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit në kuadër të dhënies së informacionit në lidhje me rastin konkret. Pas shqyrtimit të parashtrimeve, bazës ligjore të mësipërme, gjykon se pretendimi që publikimi i listës së debitorëve është i bazuar në këto akte, është i gabuar. Në asnjë nga referencat ligjore të cituara, nuk parashikohet publikimi i listës së debitorëve, ato sanksionojnë në përgjithësi mekanizmat ligjor që kanë të dyja palët për të garantuar të drejtat dhe detyrimet, të studentëve si subjekte të të dhënave personale dhe të Fakulteteve në varësi të Universitetit të Tiranës si kontrollues të të dhënave personale.

Referimi i kontrolluesit në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" në nenin 6, pika 1 paragrafët a), c), ç), d) si dhe pika 3, nuk

është i saktë, aty përcaktohen kriteret ligjore për përpunim dhe rastet në të cilat mund të përpunohen të dhënat personale. Në pikën 3 të tij, parashikohen rastet kur përpunohen të dhënat personale, të cilat janë marrë nga lista publike të dhënash, përpunimi i të cilave në çdo rast nuk mund të vazhdojë nëse subjekti i të dhënave ka shprehur mospajtim ose ka kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të tyre. Kontrolluesi të dhënat e studentëve nuk i ka siguruar nga lista publike të dhënash por në zbatim të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në këtë kuadër, Kontrolluesi duhet të respektojë me rigorozitet nenin 2, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", parimin e përgjithshëm, "Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private".

Në çdo rast, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, ka detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave personale. Ky detyrim rrjedh nga përcaktimet e nenit 18/1, të Ligjit të mësipërm "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij".

Standartet që përcakton ligji, në nenin 5 dhe 6 të tij apo nenet e tjera mbi përpunimin e të dhënave personale si saktësia e mbledhjes së informacionit, informimi, pëlqimi, mjaftueshmëria etj, i referohen jo vetëm trajtimit nga kontrolluesit të informacionit personal që nuk ka për qëllim të bëhet publik por, gjithashtu përcaktojnë standarte që së bashku lehtësojnë mbledhjen dhe trajtimin e duhur të informacionit.

Meqënëse informimi i studentëve në lidhje me detyrimet e tyre të prapambetura është një detyrim ligjor i kontrolluesit, për t'ju ardhur në ndihmë atyre të cilët nuk kanë dorëzuar mandatin e pagesës së kryer, në mënyrë që ata të mos penalizohen para fillimit të sezonit të provimeve, kontrolluesi duhet të gjejë mënyra alternative informimi dhe jo publikimin e të dhënave të tyre për këto detyrime.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit Procedurave Administrative;

REKOMANDOJ:

1. Të merren masat e duhura teknike dhe organizative për të bërë të mundur heqjen e listës me emrat e studentëve debitor nga stenda e ambjentit të subjektit kontrollues Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.
2. Ky detyrim të plotësohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij rekomandimi.
3. Të merren masat e duhura dhe të tregohet kujdes në vazhdimësi që, në raste të tilla të ngjashme të gjenden mënyra alternative njoftimi, të cilat mos të anashkalojnë respektimin

e nenit 5, 6 dhe 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1, të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
